

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PER AKTIVITETIN



SUBJEKTI : «NOSTA OIL» SH.A.

Klasifikimi i projektit: Në bazë të Ligjit nr.52/2020 te date 30.04.2020 per disa ndryshime te ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", ky aktivitet perfshihet ne Shtojca I, Industria Energjitike, **piken ID 1.9** " Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe i nenprodukteve te saj:

a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te sajne/nga nje çisternee levizshme, çisterne hekurudhore ose anije e ujrave te brendeshme ne terminal.

b. Shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisternat e stacioneve te furnizimit me karburant.

ADMINISTRATOR I SUBJEKTIT: FRANZ WEGLEITNER

Hartoi materialin Studio Mjedisore « D.E.A. PROJEKT » Sh.p.k.

VENDODHJA: DURRES, DURRES, DURRES, FSHATI RINIA, PORTO-ROMANO, DEPOZITAT BREGDETARE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. HYRJE

2. QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

2.1 Pershkrimi i projektit

2.2 Te dhena teknike te Aktivitetit

2.3 Vendodhja e aktivitetit

3 INFORMACION MBI QENDRAT E BANUARA NE ZONEN KU PROPOZOHET PROJEKTI

4 SKICA DHE PLANIMETRIT E OBJEKTEVE TE PROJEKTT DHE STRUKTURAVE TE PROJEKTIT

5 PERSHKRIMI I PROCEVE TEKNOLLOJIKE,PERFHIRE KAPACITETET PERPUNUESE.

6 INFORMACION PER INFRASTRUKTUREN E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK,FURNIZIMIN ME UJE,SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA DHE MBETJET,SI DHE INFORMACION PER RRUGET EGZISTUESE APO NEVOJEN PER HAPJE TE RRUGEVE TE REJA.

7 INFORMACION PER LIDHJET E MUNDESHME TE PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PERRETH ZONES SE PROJEKTIT

8 INFORMACION PER ALTERNATIVAT E MARRA NE KOSIDERATE PER SA I TAKON PERZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLLOJISE QE DO TE PERDORET.

9 TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.

10 INFORMACIONIN PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LIÇENSAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPUTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LIÇENSIMIN E PROJEKTIT.

1. HYRJE

Mjedisi eshte burimi i gjithçkaje per te cilen njerezit kane nevoje per te jetuar dhe per tu zhvilluar. Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomiko-social, prandaj duhet nje menaxhim sa me mire i mjedis.

Vendi yne eshte anetare i nje numri konventash nderkombetare, si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomik-social-mjedisor, per rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Raporti për më tepër do të sigurojë një plan për lehtësim dhe një program monitorimi të cilat mund të zbatohen gjatë periudhës së zhvillimit të projektit.

Ky Raport do te paraqese nga njera ane rendesine e zbatimit te projektit **piken ID 1.9, "Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe i nenprodukteve te saj:**

a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te sajne/nga nje çisternee levizshme, çisterne hekurudhore ose anije e ujrave te brendeshme ne terminal.

b. Shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisternat e stacioneve te furnizimit me karburant".

përshkrimin e këtij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore në mjedis, masat zbutese për të minimizuar sa më shumë të jetë e mundshme këto ndikime negative, duke llogaritur se si qëndron ekuilibri ndërmejt tyre për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm.

Të paraqesë realizimin e ketij projekti dhe zhvillimin ekonomik që përfitohet prej zbatimit të tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin "e zhvillimit të qëndrueshëm". Ky dokument prezanton gjithashtu dhe palët që marrin pjesë, përfitojnë apo preken nga zbatimi i tij.

Shoqeria "NOSTA OIL" Sh.A. me administrator z.Franz Wegleitner është një subjekt i cili prej vitesh zhvillonë aktivitetin e tij ekonomik "Shitje me shumice e produkteve kimike te hidrokarbureve, mineraleve, import eksport i hidrokarbureve krudo dhe te produkteve te paperpunuara te tyre. Cdo aktivitet tjetër te lidhur apo indirekt ose qe rrjedh nga aktivitetet e siperpermendura, ne perputhje me legjislacionin Shqipetar.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka nje qarkullim te paket te automjeteve. Gjithashtu pozicionim buze rruges kryesore krjon lehtesira per automjete qe furnizohen ne kete pike.

2. QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

2.1 Pershkrimi i projektit

Qëllimi i Shoqërisë ka qenë dhe mbetet përmbushja e kërkesave për kaburant me cilësi të mirë në vend dhe për këtë kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilësisë në të gjitha hallkat e aktivitetit.

Aktiviteti ka për qëllim: Depozitimin dhe Tregetimin e hidrokarbureve për automjetet me motor me djegie të brendshme.

Subjekti "NOSTA OIL" Sh.A. e ushtron këto aktivitete prej vitesh dhe është pajisur me të gjithë dokumentacionin përkatës për ushtrimin e këtij aktiviteti. Aktualisht Subjekti për ushtrimin e këtij aktiviteti disponon depozitat dhe mjetet e transportit si dhe dokumentacionin e nevojshëm për këto aktivitete.

Referuar Shtojcës 1 të ligjit 52/2020 datë 30.04.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR" aktiviteti i "Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe i nenprodukteve të saj:

a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve të saj në çisterna të palevizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve të saj nga një çisternë lëvizshme, çisternë hekurudhore ose anije e ujërave të brendshme në terminal.

b. Shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve të saj në çisternat e stacioneve të furnizimit me karburant" klasifikohet për tu pajisur me Leje Mjedisi të tipit B (Shtojca 1, pika 1.9).

Për këto arsye Subjekti "NOSTA OIL" Sh.A. po ndjek procedurat për tu pajisur me Leje Mjedisi të Tipit B për vazhdimin e ushtrimit të aktivitetit Depozitimin dhe Tregetimin e hidrokarbureve për automjetet me motor me djegie të brendshme.

2.2 Te dhena teknike të Aktivitetit

Shoqëria "NOSTA OIL" Sh.A. me administrator z. Franz Wegleitner, është i regjistruar në QKR me datë 31.01.2011, dhe është pajisur me çertifikatën e regjistrimit si person juridik, me numër NIPT L 11331010 B, si dhe ka dokumentacionin e kontratave që ka lidhur për furnizimin me ujë dhe energji elektrike ku midis veprimtarive të tjera ka dhe "Depozitimin dhe Tregetimin e hidrokarbureve".

Subjekti "NOSTA OIL" Sh.A. me administrator z. Franz Wegleitner ushtron aktivitetin në Adresën: Durrës, Durrës, Durrës, Fshati Rinia, Porto – Romano, Depozitat Bregdetare. Godina në të cilën ndodhet aktiviteti, është pronë private e marrë me qera nga Shoqëria "NOSTA OIL" Sh.A.

Ky objekt shtrihet ne nje terren te rrafshet ndersa prona eshte e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem.

Ndertesa ku zhvillohet aktiviteti eshte prone private e marre me qera nga Shoqeria e cila ka nje siperfaqe totale te prones $21.000 + 4.200 = 25.200 \text{ m}^2$, e rregjistruar ne Z.V.R.P. ne zonen kadastrale Nr. 3184, me Nr.Pasurie 65/108,64/116, ne regjistrin hipotekor me Date 16.11.2017.

Aktiviteti ushtrohet ne nje siperfaqe ndertimi $1215 + 886 \text{ m}^2$ dhe kufizohet:

Nga Veriu ----- 65/91

Nga Jugu ----- 97/1

Nga Lindja ----- 65/105

Nga Perendimi --- 98

Prane aktivitetit kalon **Rruga Nacionale Durres – Katundi i Ri**. Ne kete zone nuk ka patur dhe tani as nuk ka asnje bimesi te larte (dru pyjore ose peme frutore).

Depozitat e Karburantit eshte i pajisur me te gjitha aksesoret e nevojshem per kete aktivitet duke plotesuar kerkesat e mbrojtjes se mjedisit.

Zyrat 2 kat jane ndertuar prej tulle dhe betoni. Aktiviteti eshte i mbyllur nga pjesa mbrapa, me hyrje dalje.

Ne zonen ku do te zhvillohet ky aktivitet ka shtepi banimi, shkolla, dhe aktivite te tjera social kulturore, por qe nuk mund te demtohen nga zhvillimi i ketij aktivitetit nga subjekti.

Objekti ku zhvillohet aktiviteti eshte i sheshte, ne kuoten e ruges.

E tere hapësira ku zhvillohet aktiviteti eshte sistemuar, asfaltuar duke bere te mundur realizimin e nje imazhi pamor mjedisor me cilesor, dhe ka ndikuar ne permirsimin e ndotjes mjedisore dhe permirsimin e pamjes vizuale.

Aktiviteti zhvillohet ne nje siperfaqe te ndertuar $1215 + 886 \text{ m}^2$.

Depozitat e karburantit eshte e shtruar me asfalt dhe mbahet paster.

Produktet qe magazinohen dhe tregtohen.

- Naftë
- Benzine

Subjekti, për vazhdimin e ushtrimit te aktivitetit të tij do të pajiset me të gjitha miratimet përkatëse të lejeve të nevojshme për funksionimin e tij, **Referuar Shtojces 1 te ligjit 52/2020 date 30.04.2020 "PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 448, DATË 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", TË NDRYSHUAR"** aktiviteti "Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe i nenprodukteve te saj:

a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te sajne/nga nje çisternee levizshme, çisterne hekurudhore ose anije e ujrave te brendeshme ne terminal.

b. Shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisternat e stacioneve te furnizimit me karburant" klasifikohet per tu pajisur me Leje Mjedisi te tipit B (Shtojca 1, pika 1.9). klasifikohet per tu pajisur me Leje Mjedisi te tipit B (Shtojca 1, pika 1.7 dhe 1.10).



2.3 Vendodhja e aktivitetit

Subjekti "NOSTA OIL" Sh.A. me administrator z. Franz Wegleitner ushtron aktivitetin ne Adresen: **Durres,Durres,Durres,Fshati Rinia,Porto – Romano,Depozitat Bregdetare.** Nderesa ku zhvillohet aktiviteti eshte prone private e marre me qera nga Shoqeria e cila ka nje **siperfaqe totale te prones $21.000 + 4.200 = 25.200 \text{ m}^2$** , e rregjistruar ne Z.V.R.P. ne zonen kadastrale Nr. 3184,me Nr.Pasurie **65/108,64/116**, ne regjistrin hipotekor me Date **16.11.2017**.

Aktiviteti ushtrohet ne nje **siperfaqe ndertimi $1215 + 886 \text{ m}^2$** dhe kufizohet:

Nga Veriu ----- 65/91

Nga Jugu ----- 97/1

Nga Lindja ----- 65/105

Nga Perendimi --- 98

Prane aktivitetit kalon **Rruga Nationale Durres – Katundi i Ri** qe kalon prane projektit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1527639

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 3184
 Numri i Pasurisë 65/108 Volumi 9 Faqe 25
 Adresa e Pasurisë RINIA
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 21000 m²
 Nga kjo : Sa Truali 21000 m² Nga kjo : Sa Ndërtesa 1215 m²
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
<u>KASTRATI</u>	<u>SH.A.</u>		<u>1</u>	<u>RINIA</u>

- është pronar i 65/108
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V 65/91 L 65/105 J 9711 P 98

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajteshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga (i/a) interesuari (t) më datë 16.11.2017 Nr. 1527639

Data e lëshimit të çertifikatës

16.11.2017

Lëshues i çertifikatës
REGJISTRUESI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME



ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1869471

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 3184
 Numri i Pasurisë 64/116 Volumi 10 Faqe 140
 Adresa e Pasurisë RINIA
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 4200 m²
 Nga kjo : Sa Truall 4200 m² Nga kjo : Sa Ndërtesa 886 m²
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"KASTRATI"		SH.A	?	DURRES


- është pronar i 64/116
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V 64/115 L 100 J 97/1 P 64/14

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së Përfaqësuesit nga (të) Interesuar/(t) me datë 26.05.2018 Nr. 9462

Data e lëshimit të çertifikatës


06.05.2018




E tere hapësira ku zhvillohet aktiviteti është sistemuar, asfaltuar duke bërë të mundur realizimin e një imazhi pamor mjedisor me cilësor, dhe ka ndikuar në përmirësimin e ndotjes mjedisore dhe përmirësimin e pamjes vizuale.

Zona e përzgjedhur për ushtrimin e këtij aktiviteti është e përshtatshme për këtë lloj aktiviteti duke pasur parasysh përparesit si:

- Furnizimi me ujë;
- Furnizimi me energji elektrike
- Lehtësi në aksesim nga automjetet (cisternat, automjetet që furnizohen, zjarrfikset dhe ambulancat)





Pamje e vendosjes se aktivitetit


Sistemi koordinativ	X	Y
Gauss Kruge	4363700.484	4584248.586
Gauss Kruge	4368858.047	4584311.184
Gauss Kruge	4368768.779	4584099.359
Gauss Kruge	4368949.165	4584198.103
KRGJSH	452220.394	4583066.489
KRGJSH	452405.194	4583142.099
KRGJSH	452290.394	4582934.889
KRGJSH	452472.394	4583021.689

3. INFORMACION MBI QENDRAT E BANUARA NE ZONEN KU PROPOZOHEK PROJEKTI

Qarku i Durrësit zë një sipërfaqe prej 76 000 ha dhe shtihet në Ultësirën perëndimore të Shqipërisë Qëndrore.

Qarku përfshin dy rrethe, Durrës dhe Krujë.

Qarku i Durrësit ka 351,899 banorë dhe 90,939 familje me 495 banorë për km².



Nr. Posaq.	Emri i Komponentit	Sasia (në mm)	Baza	Materiali	Peshë në KG	
					Mjeti	Total
1	TUPËRJA	300		ASTMA 100 DL 8	8.5	8.5
2	FLANSHI E (808)	1		ASTMA 105	8.6	8.6
3	VALI (808)	1		8 205-85 EN 10025	18.4	18.4

Projektimi i Hidrologjik dhe Konstruktiv		REZERVIUARI Y e 25.872 m ³ Poro Rrethorë - Dorre Kompania "KASTRAITI" Sh.a		Nr. Vizimit 039-44-01-19
Projektuesi	Kristina STRATI	Nr. L.M.-003	Fazat:	Shtalla 1/5
Projektuesi	Luis KECI	Nr. L.M. 14971	Projekt Zbatimi	
Projektuesi	MIRSAH MATJA	Udhëzuesi		Fletë Nr.
Ponuesi	"KASTRAITI" Sh.a.	Nr. S.	TRANSPORTI, REZERVIUARI E REZERVIUARI	Gjithësi
Investuesi				8. P. 18



5 PERSHKRIMI I PROCEVE TEKNOLOGJIKE,PERFHIRE KAPACITETET PERPUNUESE.

Instalimi per nenproduktet e lengeta te naftes.

Bazamenti i rezervuareve dhe digave per nenproduktet e lengeta te naftes.

Rezervuaret prej celiku per magazinimin e ngarkesave te lengeta me kapacitet e meposhtme:

Depozita Nr. 3 = 4663.508 m³

Depozita Nr. 6 = 932.088 m³


Kapaciteti mbajtes i rezervuareve te vegjel eshte akoma me i ulet. Ne vendndodhjen e terminalit te ardhshem per magazinim dhe transportim te ngarkesave te lengeta, deri me tani nuk jane bere studime gjeomekanike. Ne baze te studimeve te bera per zonen e gjere te Porto Romanos dhe perberjes se dheut, jepen propozimet e bazamentit.

Bazuar ne madhesine e siperfaqes per magazinim, ne parashikojme studime gjeo- mekanike te tjera te zones se planifikuar. Avantazhi i variantit per bazamente le thella, eshte se ndertimi mund te filloje menjehere. Ne sugjerojme berjen e bazamenteve me beton monluar nga pilote le ngulura me gjatesise 12-14 m pa lidhje, te cilat kthejne ngarkesat vertikale ne ferkim. Mbi pilotet, ne tere siperfaqen e rezervuari ndertohet pllaka e armuar prej betoni si baze per dyshemene e rezervuarit. Nepermjet ketij varianti nuk menjanohet fundosja e rezervuarit, por zvogelimi i saj. Ne menyre qe te ndalojme fundosjen e rezervuareve do te jete e nevojshme shtrirja e bazamentit si dhe pllakes baze mbi pilole te cilet jane te ngulur ne dheun mbajtes. Kjo realizohet nga lidhja e piloteve te bashkengjitur prej betoni ose me tuba-pilote te salduar me diameter te pershtatshem. Rezervuari dhe siperfaqja mbledhese prej celiku do shtrije bazamentin si nje pllake, mbeshtetur thelle ne pilotet e ngulur ne rrathe koncentrike ne ate menyre qe distanca e vendosjes te jete e pershtatshme per kapacitetin mbajtes te piloteve.

Menaxhimi i instalimit

Menaxhimi i instalimit behet nga nje staf i trajnuar per te operuar dhe per te ushtruar kete aktivitet. Perfaqesohet nga departamente te ndryshme te cilet kryejne funksionin e tyre dhe realizojne operimin e kesaj Shoqerie Konform te gjitha rregullave tatimore, fiskle, dhe atyre mjedisore. Ajo qe vlen per tu permendur eshte qe skema e funksionimit te kesaj Shoqerie perfaqesohet nga organigramet e cila tregon kete funksionim dhe ndarje te detyrave.

Prodhimi perfaqesohet nga inxhinier dhe teknike te specializuar ne perdorimin e makinerive, te trajnuar jashte per mirefunksionimin e tyre dhe shfrytezimin efficient te tyre. Financa eshte department i cili perfaqesohet nga studio ligjore e nenkontraktuar dhe nga ekonomist te brendshem ne kalkulimet dhe ruajtjet e sakta te informacionit kontabel. Magazinimi perfaqesohet nga shefi i magazines me asistentet e tij, ndersa mirembajtja eshte nje department i ri i cili ne rastin konkret ka nje rendesi ne perdorim te programit financa 5 qe Subjekti perdor.



Depozitat e naftes

Njesia e ngarkimit te autoboteve

Eshte projektuar konstruksioni i njesise se ngarkeses me tre vende (ishuj) si dhe streha e tyre. Plateja per mbushjen e autoboteve eshte projektuar me gjeresi 27,5 m dhe gjatesi 16,5m. Ishujt me gjeresi 3,5m. Ishujt jane parashikuar te jene me lartesi 10-20 cm mbi shesh, si pllake prej betoni te armuar me lartesi 10cm, C25/30, e papershkueshme nga uji me pjerresi minimale ne drejtim te sheshit per mbushje. Mbi «ishuj» do te instalohet streha me strukture prej çeliku dhe me platforme sherbimi. Lartesia e strehes do te jete rreth 6,5m. Streha do te mbulohet me llamarine çeliku te zinkuar te ngjyrosur ne forme trapezi, dhe platforma e sherbimit me rrjet te zinkuara ne te nxehte. Aksesit tek platforma e sherbimit, e cila sherben per vendosjen e kraheve per zbrazje/mbushje per mbushje nga poshte, eshte siguruar me shkalle çeliku. Aksesit tek çisterna eshte siguruar me ura hidraulike. Lartesia e platformes eshte rreth 2,8 m, dhe gjeresia e saj eshte rreth 1,4m.



Stacioni i ngarkimit te autoboteve

Stacionet e pompes I stacionet filtruese

Ne pllaken e dyshemese te struktures mbrojtese prej betoni te armuar (digat) vendosen themelet e pompave dhe pajisjet e tjera inxhinierike (siç jane filtrat).

Tubacionet e perdorur

Te gjitha linjat e tubacioneve vendosen mbi toke mbi mbeshtetese prej betoni te armuar. Ne pikat e kryqezimit te linjave, tubacionet vendosen ne mbikalimet prej betoni te armuar ose jane vendosur mbi mbeshtetese prej çeliku. Lartesia minimale e pikes me te ulet te mbeshteteses eshte 4,5 mbi rruge.

Njesia per perpunimin e avujve te hidrokarbureve me gazsjelles

VRU eshte njesia per trajtimin e avujve te hidrokarbureve vendosur ne nje strukture mbrojtese prej betoni te armuar. Bazamenti i gazsjellesit do te realizohet ne te njejten menyre si bazamentet e rezervuareve te nenprodukteve te lengeta te naftes.

Sistemi per perzierjen

Sistemi per perzierjen do te vendoset ne strukture mbrojtese prej betoni te armuar.

Sistemi slop.

Rezervuarët per mbetjet (slop) do te vendosen ne struktura prej betoni te armuar te papershkueshem nga uji. Parashikohet rrjedhja e kontrolluar nga strukturat mbrojtese.

Baza e rezervuarit per mbrojtje nga zjarri

Ndertimi i bazes te rezervuarit per uje do te behet ne te njejten menyre si bazamenti i rezervuarit te nenprodukteve te lengeta te naftes.

Stacioni i pompave te ujit kunder zjarrit dhe transformatorit.

Objekti eshte me tulla tokesore. Çatia eshte prej betoni te armuar, me nje strehe. Konstruksioni do te mbulohet me panele termale prej çeliku te zinkuar ne forme trapezi dhe e ngjyrosur.

Ato mbushen me lesh mineral.


Objektet e tjera derguese

Dimensionet dhe pamja e jashtme e stacionit te fuqise per pergatitjen e avullit per ngrohje te biolendeve djegese si dhe stacionit te kompresorit per ajer.

Njesia e mbushjes se autoboteve

Parashikohet njesia e mbushjes me nje ishull dhe streha mbi te. Plateja e njesise se mbushjes se autoboteve parashikohet te jete e gjere 10,5m, e gjate 16,5 m. Ishulli eshte e gjere 3,5m dhe sherben per vendosjen e krahut per mbushje/zbrazje . «Ishulli» eshte i parashikuar te jete i larte 10-20 cm mbi plate si pllake betoni te armuar me lartesisë 10 cm, C25/30, i padeptueshem nga uji, me pjerrtesi minimale ne drejtim te platese per mbushje. Mbi «ishull» do te vendoset konstruksioni i strehes prej çeliku me lartesisë rreth 4,5 m.

Streha eshte mbuluar me llamarine çeiku te galvanizuar trapezoid e te lyer.



Pompe hidranti e MNZ

Rregullat e zbatuara, rregulloret dhe normativat

Ne hartimin e dokumentacionit projektues dhe zhvillues jane shfrytezuar rregullat, standardet dhe normat e Republikes se Shqiperise, ato Evropiane dhe rregullat e tjera nderkombetare.

Standardi i rregullave per rezervuaret dhe tubacionet

Rezervuaret atmosferike

Jane ene cilindrike vertikale te ndertuara me flete çeliku te markes se spesorit te caktuar sipas llogaritjeve teknike, te bashkuara me disa breza unazash te salduara me elektroda te markes qe i pershatatet llmarine sse çelikut. Ndertimi i tyre realizohet sipas nje teknologjie te posaçme e me kushtet e norma teknike te percaktuara ne standartet perkates europiane per prodhimin e tyre, si dhe kushtet teknike te montimit te rezervuareve.

Rezervuaret e karburantit do te jene te konstruksionit standart normal, par rezervuaret cilindrike metalike vertikale, mbitokesor, kjo per arsyen e vetme, uljen ne maksimum te humbjeve gjate manovrimeve per mbushjen e zbrasjen e rezervuareve.

Kapaku notues shoqeron ne menyre te vazhdueshme nivelin e lengut ne rezervuar e nuk lejon hapesine per avullime te shkalles se larte. Me ngritjen e nivelit ne rezervuar, ngrihet dhe kapaku notues dhe e kunderta, edhe keta rezervuare si ata standarte kane bokaporta kontrolli, drite (hyrje), paisje matese, valvola sigurie e frymemarrje te vendosura ne kapak.

Ne rastin kur rezervuari eshte ne procesin e mbushjes, per ngritjen e kapakaut notues eshte e domosdoshme te merren parasysh pesha e kapakut me gjithe paisjet, si dhe prurjet per shkak te reshjeve atmosferike (shi, debore) si dhe forcat e ferkimit midis kapakut notues e pareteve te rezervuarit.

Sistemi i tubacioneve dhe i armaturave.

Ne kete sistem perfshihen te gjitha tubacionet dhe armaturat, te cilat realizojne te gjithe levizjen e lengjeve, duke perfshire karburantet, ujerat teknologjike (shkarkimet), shkumes zjarrfikese per rezervuaret e karburanteve.

Parku i rezervuarve si dhe sistemi i tubave eshte kompozuar dhe montuar nentoke.

Tubacionet e perdorur ne te gjitha linjat teknologjike jane te klasifikuar per produkte te naftes, qe transportojne hidrokarbure me pike flakerimi nga 30 C° deri ne 100 C°, qe i pergjigjet benzines dhe gazoilit.

Tubacionet e perdorur jane klasifikuar per regjim konstant shfrytezimime parete te pandryshueshme me regjim izotermik shfrytezimi dhe per presion 10 MPA.

Diametrat e tubave te linjave teknologjike jane percaktuar me metoden e llogaritjeve hidraulike duke pranuar shpejtesine e rrjedhies se lengut ne tubacionet, ndersa ne tubacionet e dergimit 2-3 m/sek.

Ne keto tubacione ne vende te caktuara do te vendosen saracineska e valvola per realizimin normal te levizjes se lengjeve. Tubacionet dhe armaturat zgjidhen ne funksion te lengjeve qe levizin ne tubacion, duke i pershtatur standarteve Evropiane.

Standardi i rregullave per rezervuaret dhe tubacionet.

Projektet mekanike te tubacioneve duhet te jene ne perputhje me specifikimet dhe standardet ne vijim. Nese nuk eshte percaktuar ndryshe ne kerkesen per furnizim ose kontrate, do te shfrytezohet botimi i fundit inormave dhe standardeve.

Masat kunderzjarrit dhe udhezimet.

Mjetet e pershtatshme: shkuma e ajrit, pluhur, CO₂, halonet, mjegulla ujore dhe sprai. nuk duhet te perdoret :vrushkulli i ujit

Verejtjet speciale per rrezikun nga zjarri: Te menjahohen te gjitha burimet e mundshme ndezese, menjehere te thirret policia dhe zjarrfikesit.

Verejtje te vecanta per mbrojtje te zjarrfikeseve: Aparat izolues me drite te mbrojtur, komplet per mbrojtje nga nxehtesia.

Masat gjate derdhjes.

Masat personale te sigurise: Te perdoren pajisjet mbrojtese personale.

Masat per mbrojtje te mjedisit: Te menjanohen rrjedhjet dhe derdhja ne shtratin e ujit dhe sistemi i drenimit duke vendosur dige dhe parmak.

Sistemi per shperndaen e nenprodukteve te naftes permban:

- Matjen e volumit te nenprodukteve te naftes, ne njesine e ngarkimit te autoboteve dhe boteve hekurudhore, me sasine e deshruar dhe te paracaktuar.
- Matjen e benzines gjate shperndarjes me njesine e matjes induktive.
- Sistemi kryen kompensimin automatik te temperatures te lendes djegese gjate shperndaes.
- Gjithashtu kryhet kontrolli i tokezimit dhe bllokimit te mbushjes te autoboteve tek mbushja e poshtme e autoboteve, sistemi mundeson mbrojtjen nga mbimbushja , dhe se bashku me sistemin tjetër realizon mbrojtjen nga mbimbushja gjate mbushjes nga sipër.
- menaxhimi ne distance i pompave per shpemdæ te nenprodukteve te naftes dhe pompave te aditiveve.

Menyra e pastrimit dhe grumbullimit.

Nga rezervuari i demtuar, me pompe e ne menyre te sigurite te transportohet ne cisterne- rezervuar te zbrazet, te menjanohen mbetjet me thithje me byk sharre, rere, me ndjathithes mineral dhe menyra te ngjashme me keto. Keto materiale- mbeturina si dhe shtresa siperfaqesore e dheut te kontaminuar dhe te menjanuar, ne vendet me se tepermi te ndotura, te depozitohen ne menyre te sigurt, (ne ene te pershtatshme), dhe menjehere te dergohen ne perpunim.

Verejtje shtese:


Te menjanohen te gjitha burimet e mundshme ndezese, te njoftohen zjarrfikesit, sa me shpejte te nderpritet derdhja. Ne vend te dukshem te vendoset shenja per ndalim- hyrje dhe per pune me zjarr te hapur, si dhe me mjete te cilat leshojne xixa.

Sipas rregullave te behet tokezimi i çisternes.

Ndertesa administrative dhe e kontrollit

Dimensionet dhe pamja e jashtme e objektit jane dhene ne formen grafike te projektit. Pjesa administrative dhe e komandimit dhomes se kontrollit jane parashikuar ne ndertesën 2 kat. Vendi per

depozitimet e reres dhe punetorese jane parashikuar si perdhese. Ne godine jane vendet per garderobe per punetoret, dhe nje dhome e vogel per ngrenie si dhe vendet sanitare me kabinat e dushit. Ne godine kemi zyra te drejtuesve si dhe nje salle e vogel per zhvillimin e mbledhjeve.



Pamje e zyrave te Shoqerise.

6. INFORMACION PER INFRASTRUKTUREN E NEVOJSHME PER LIDHJEN ME RRJETIN ELEKTRIK, FURNIZIMIN ME UJE, SHKARKIMET E UJRAVE TE NDOTURA DHE MBETJET, SI DHE INFORMACION PER RRUGET EGZISTUESE APO NEVOJEN PER HAPJE TE RRUGEVE TE REJA.

Lidhja e objektit me infrastrukturen inxhinjrike

Aktiviteti në vlerësim ndodhet në **Durres, Durres, Durres, Fshati Rinia, Porto – Romano, Depozitat Bregdetare.**

Sheshi ku do zhvillohet aktiviteti në fjalë ndodhet në brendësi të pronës dhe nuk cenon pronat e tjera përreth.

Vendosja e këtij aktiviteti në këtë zonë është e përshtatshme për zhvillimin e këtij aktiviteti pasi zona ka një qarkullim të paket të automjeteve. Gjithashtu pozicionimi buze rruges kryesore si edhe krijimi i rrugeve hyrese dhe daljeve krojojnë lehtësira për automjetet.

Infrastrukturat në zonën e ushtrimit të aktivitetit është e gatshme ku përfshihen, infrastruktura rrugore, rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm, rrjeti i furnizimit me energji elektrike, rrjeti i shpërndarjes së internetit si edhe rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza.

Funksionimi i këtij Projekti nuk do të ndikojë në dëmtimin ose devijimin e infrastrukturës ekzistuese. Në pronë sigurohet akses nëpërmjet rrugës ekzistuese e cila është e shtruar. Për të gjithë zonën e studiuar, objekti do të plotësojë nevojat e tij për ujë higjieno-sanitar nëpërmjet shfrytëzimit të rrjetit ekzistues dhe përsa i përket sistemit të shkarkimit të ujrave është lidhur me kanalizimet ekzistuese në zonë. Mbetjet e ngurta do të menaxhohen në bashkëpunim me Bashkinë Durrës dhe do të përcaktohet vendi i depozitimit të tyre nga Bashkia.

Pastrimi i mbetjeve urbane do të kryhet nëpërmjet vendosjes së koshave të mjaftueshëm.

Largimi i ujrave të zeza dhe i ujrave atmosferike bëhet përmes kanaleve deri te puseta për mbledhjen e ujrave të zeza e cila llogaritet sipas kapacitetit. Puseta vendoset në pjesën ku me se paku i pengon aktivitetin.

Energjia Elektrike që nevojitet për pusin do të merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratës përkatëse.

Ka rrugë të mira në zonë dhe në brendësi të Projektit, nuk do të hapen rrugë të reja për këtë qëllim por do të shfrytëzohen ato ekzistuese.

Nuk do të ndërtohet ujësjellës i ri.

Nuk do të ndërtohet rrjet elektrik i ri.

Mbetjet e prodhuara

Mbetjet e gjeneruara do të grumbullohen në pika grumbullimi ose vend depozitime të caktuara nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V).

Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësine e Qeverisjes Vendore dhe firmën pastruese të territorit.

Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim.

Mbetje janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetje organike.

Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar.

Depozitimi i mbetjeve inerte do të bëhet në përputhje me "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme" si dhe VKM nr.371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme".

Impakti i mbetjeve të prodhuara mbi mjedisin mund të konsiderohet i pranueshëm.

Referuar VKM Nr. 99, datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve", mbetjet që prodhohen klasifikohen me kodet:

17 02 03	Plastikë
20 01 01	Letër dhe karton,
20 01 02	Qelq,
20 01 39	Plastikët,
20 01 40	Metalet,

Gjendja ekzistuese e rrugëve

Ekzistojnë rrugë aksesit përgjatë kufijve në lindje dhe në jug të projektit. Rrugët kryesore përgjatë kufirit perëndimor dhe gjatë qendrës së zonës janë të ndërtuara, ndërkohë që zona do ketë së shpejti një plan të studiuar dhe të miratuar të infrastrukturës rrugore.

Nuk është e nevojshme hapja e rrugëve të reja për projektin.

7. INFORMACION PËR LIDHJET E MUNDËSHME TË PROJEKTIT ME PROJEKTET E TJERA EKZISTUESE PËRRETH ZONËS SE PROJEKTIT

Projekti shtrihet në zonën e Porto Romanos, pranë parkut energjetik dhe industrial. Siç është e njohur, në këtë zonë janë ndërtuar depozita për karburante të lengëshme nga kompani të ndryshme. Në këtë mënyrë projekti do të bëhet pjesë e parkut energjetik dhe industrial.

8. INFORMACION PËR ALTERNATIVAT E MARRA NË KONSIDERATE PËR SA I TAKON PËRZGJEDHJES SE VENDODHJES SE PROJEKTIT DHE TEKNOLOGJISE QË DO TË PËRDORET.

Për përcaktimin e vendit të vendosjes së projektit janë bërë studime dhe matje paraprake nga vete Shoqëria, kushtet klimatike, dhe tregues të tjerë të nevojshëm.

Zhvilluesi "NOSTA OIL" SH.A. në rolin edhe të Subjektit që do bëjë përmirësim të veprimtarisë së vet me vendqendrimin të veprimtarisë në Porto Romano, Durrës. Ky projekt zhvillohet në zonën industriale dhe energjitike të Porto Romanos, brenda zonës së zhvillimit të industrisë. Zgjidhja optimale e projektit të siguron shërbim me teknologji të mëtejshme dhe me siguri teknike.

Ane pozitive të këtij projekti është se, rreth tij nuk ka ambiente banimi, familjare por megjithatë duke u mbështetur në legjislativën e sotme të Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e mjedisit. Përparësi në këtë projekt do të jetë mbrojtja e mjedisit nga ndotja. Për të siguruar një mjedis të pastër e pa problem për personelin e shërbimit si edhe për objektet afër parkut të rezervuarëve, është parashikuar një sistem kanalizimesh, tubacionesh të cilat në bashkëveprim do të orientojnë ujërat

teknologjike, ujerat natyrale dhe ujerat e shkarkimit te rezervuarve ne separatoret perkates ne secilin rezervuar te gazoilit, po ashtu dhe separator i perbashket per 2 shkarkimet e rezervuareve te naftes.

9. TË DHËNAT PËR PËRDORIMIN E LËNDËVE TË PARA GJATË FUNKSIONIMIT, PËRFSHIRË SASITË E UJIT TË NEVOJSHËM, TË ENERJISË, LËNDËVE DJEGËSE DHE MËNYRËN E SIGURIMIT TË TYRE.

Karakteristikat kryesore te hidrokarbureve qe do te transportohen dhe depozitohen ne depozitat bregdetare jane renditur me poshte:

- Dendësia: 740.0 kg/m³ ne 15.6°C;
- Viskoziteti kinematik: 0.40cSt ne 40.0°C; 0.30cSt ne 50.0°C;
- Presioni i vërtete i avujve: 86kPa ne 37.8°C.

Karakteristika te gazoilit

- Dendësia: 840.0 kg/m³ në 15.6°C;
- Viskoziteti kinematik: 2.2-4.5 cSt ne 40.0°C; 6.55cSt në 15.6°C;
- Presioni i vërtete i avujve: <3.4 kPa.

Instrumentat mates dhe kontrollues te gjendjes dhe qarkullimit te lengut.

Te gjithë instrumentet do te perzgjidhen ne baze te funksionit, sherbimit dhe klasifikimit te zonave.

Te gjitha pjeset e brendeshme te instrumenteve do te perzgjidhen ne pershtatje me kerkesat per produktet.

Veprimtaria/saktesia e instrumenteve do te jete e mjaftueshme per te permbushur kerkesat e veprimtarise se procesit/pajisjes.

Do te perdoren instrumenta te shpejte. Protokolli i komunikimit do te jete HART, i mbivendosur ne sinjalet 4-20mA.

Per instrumentet/pajisjet qe bejne pjese ne nensisteme te dedikuara, protokolli i komunikimit mund te bazohet ne MFR STD.

Vetem per arsye te kontrollit lokal, instrumentet ne terren duke perfshire edhe kontrolluesit mund te jene te llojit pneumatic.

Kur kerkohen kerkuesit lokalë, ata do te jene pjese e transmetuesve . Tregues te vecante lokal mund te instalohen vetem ne qofte se jane te domosdoshem per operim lokal.

Cdo vendosje e instrumenteve do te lejojë zhvendosjen e kokës së një sensori/dedektori nderkohe qe do te ruhet integriteti i sensoreve te tjere, p.sh. ne sistemet e adresueshme.

Instrumentet do te plotesojne kerkesat EN 500812 dhe EN 50082-2 ne lidhje me perputhshmerine elektromagnetike.

Lidhja me fllanxha per instrumentet e linjes se brendshme ne nje vije do te jete ne perputhje me klasen dhe specifikimin e tubacioneve.

Te gjithë elementet e rrjedhes ne nje linje (kur jane pjese te linjes se procesit) do te lidhen me fllanxha per tu zhvendosur nga linja e procesit.

Parimet matese qe do te perdoren ne kete projekt jane specifikuar ne pjese te vecanta te ketij dokumenti. Lloje te tjera mund te perdoren ne aplikime speciale sipas aprovimit te kontraktuesit.

Per instrumentat ne terren te trajtuara ne menyre specifike, projektimi do te bazohet ne standartet e njohura nderkombetare kur eshte e mundur. Te gjithë sistemet e kontrollit dhe te sigurise, si dhe nensistemet e linjave do te jene te pajisura me sistemin UPS.

Gjatë funksionimit të projektit,do të nevojitet uji,energjia elektrike,uje,lende djegese si dhe produkte të konsumit të përditshëm.

Uji që nevojitet për zbatimin e ketij projekti eshte marre nga rrjeti kryesor nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila eshte caktuar nga Ndërmarrja e Ujësjellësit që e ka në përdorim linjën e Ujësjellësit. Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot përkatëse në lidhje me furnizimin me ujë do të paguhen nga Shoqeria.

Furnizimi me energji eletrike

Energjia Elektrike që nevojitet për pusin do te merret nga Rrjeti kryesor elektrik nëpërmjet një matësi në pikën më të afërt të mundshme, e cila do të caktohet nga filiali i OSHEE që e ka në përdorim linjën elektrike dhe do të jepet në përdorim me anë të kontratës përkatëse.

Shkarkimet e ujërave do të lidhen me sistemin ekzistues të kanalizimeve të zonës.

Lenda djegese do te sigurohet nga pika e karburantit me te afert me Projektin.

10. INFORMACIONIN PËR LEJET, AUTORIZIMET DHE LIÇENSAT E NEVOJSHME PËR PROJEKTIN, NË PËRPTHJE ME PËRCAKTIMET E BËRA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI, SI DHE INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR LEJIMIN / AUTORIZIMIN/ LIÇENSIMIN E PROJEKTIT.

Shoqëria "NOSTA OIL" Sh.A. me administrator z Franz Wegleitner, është i regjistruar në QKR në datë 31.01.2011, dhe është pajisur me çertifikatën e regjistrimit si person juridik, me numër NIPT L 11331010 B, si dhe ka dokumentacionin e kontratave që ka lidhur për furnizimin me ujë dhe energji elektrike ku midis veprimtarive të tjera ka dhe "Depozitimin dhe Tregetimin e hidrokarbureve".

Subjekti do ndjek të gjitha procedurat ligjore për të pajisur me lejet përkatëse për funksionimin konform të gjitha rregullave të këtij projekti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA RAJONALE E TATIMEVE DURRES

Nr. T03197889

Datë, 27.11.2020

VËRTETIM

(Për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin - E-SIG 02/a)

Vërtetojmë se për Personin Juridik / Fizik NOSTA OIL, me numër NIPT-i L11331010B, me përfaqësues ligjor Z/Znj. Franz Wegleitner, në mbështetje të deklarimeve e pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të dhënave të rubrikave të formularit "Listëpagesa e kontributeve për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", të deklaruara nga subjekti, por që akoma ndodhen në Drejtorinë Rajonale Tatimore, rezultojnë keto të dhëna:

Nr	Periudha tatimore	Numri i Kontributeve	Detyrimet(kontributet, interesat) Në lekë	Pagesat(kontributet, interesat) Në lekë
1	2010	4	92,859	92,859
2	2009	3	92,859	92,859
3	2008	3	92,859	92,859
4	2007	3	92,859	92,859
5	2006	3	109,388	109,388
6	2005	3	92,859	92,859
7	2004	3	92,859	92,859
8	2003	3	92,859	92,859
9	2002	3	92,859	92,859
10	2001	3	92,859	92,859
11	1912	3	109,388	109,388
12	1911	3	92,859	92,859
13	1910	3	92,859	92,859
14	1909	3	92,859	92,859
15	1908	3	92,859	92,859
16	1907	3	92,859	92,859
17	1906	3	109,388	109,388
18	1905	3	92,859	92,859
19	1904	3	92,859	92,859
20	1903	3	88,858	88,858
21	1902	3	88,858	88,858
22	1901	3	88,858	88,858
23	1812	3	101,437	101,437
24	1811	3	86,680	86,680
25	1810	3	86,680	86,680
26	1809	3	71,907	71,907
27	1808	3	48,681	48,681

28	1807	3	56,852	56,852
29	1806	3	56,852	56,852
30	1805	3	68,137	68,137
31	1804	3	56,852	79,422
32	1803	3	56,852	79,422
33	1802	3	56,852	79,422
34	1801	3	56,852	79,422
35	1712	3	68,137	68,137

Nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datën 27.11.2020, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 27.11.2020, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime, nga të cilat:

Kontribute gjithsej: 0 lekë

Kamatëvonesa për kontributet: 0 lekë

Gjoha lidhur me kontributet: 0 lekë

Ky vërtetim lëshohet mbi të dhënat e administruara nga sistemi informatik tatimor deri më datë 27.11.2020 ora 12:02:51.

Drejtuesi i Shërbimit të Tatimpaguesve

Nisur nga sa u paraqit me lart dhe ne dokumentacionin perkates shoqerues, perfundi misht mund te themi se projekti i Subjektit "NOSTA OIL" SH.A. per piken ID 1.9, "Shperndarja dhe magazinimi i naftes dhe i nenprodukteve te saj:

a. Magazinimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisterna te palevizshme ne ndonje terminal, ose ngarkim/shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te sajne/nga nje çisternee levizshme, çisterne hekurudhore ose anije e ujrave te brendeshme ne terminal.

b. Shkarkimi i naftes dhe nenprodukteve te saj ne çisternat e stacioneve te furnizimit me karburant" ne Porto Romano, Durres me administrator z.Franz Wegleinter nuk do te sjelle pasoja negative per mjedisin e zones.


Si perfundim mund te themi se projekti qe do te ndertohet konsiderohet i pershtatshem dhe i pranueshem ne zonen e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore per zonen perreth.

Hartoi materialin
STUDIO MJEDISORE
"DEA PROJEKT" Sh.p.k.
Eksperti i Vlersimit e Auditimit Mjedisor

ARJAN BALA



Certifikuar nga Ministria e Mjedisit
Nr. 11594 Prot, Nr. identifikus 197, date 10.12.2014



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT


Nr. 11594 Prot.

Tiranë, më 10.12.2014

Nr. identifikues 197

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor".



Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

PER SUBJEKTIN

"MOSTA OIL & S.A.

PORTO ROMANO.

MINISTRI

Lefter KOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA-KOMBËTARE E BIZNESIT

LN-4030-11-2017

D.E.A. PROJEKT

NUIS/NIPT: L72115007S

LICENCË

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtarisë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor dhe Vlerësimi i ndikimit në mjedis).

Kodi III.2.A

Kodi tjetër

Data e lëshimit 2017-11-02

Afati i vlefshmërisë Pa afat

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtarisë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Veprimtari specifike

Ndikim në mjedis, Auditim mjedisor

Specialiteti

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshtkrimi i sportelit



Vulosur elektronikisht nga Qendra
Kombëtare e Biznesit
Date:2020/05/21 14:54:57 -0200
L72115007S20200521145442234006